



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Tiranë, më 25 mars 2009

**KARTAT E IDENTITETIT DHE NJOHJA E ZGJEDHËSVE ME LISTAT PARAPRAKE
JANË PRIORITYET**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) duke ndjekur me vëmendje përgatitjet për zgjedhjet e 28 qershorit 2009, në fazën e tanishme konsideron **si prioritare dhe urgjente** pajisjen e shtetasve që kanë pasaportë për jashtë shtetit, me kartat e identitetit dhe njohjen e zgjedhësve me listat paraprake të shpallura.

Sikurse në deklaratën e këtij Komiteti, të bërë më datën 9 shkurt 2009, KSHH rithekson faktin se pajisja e zgjedhësve që nuk kanë pasaportë, me karta identiteti është jo vetëm prioritare por edhe urgjente. **Çdo lloj formalizmi, ngadalësimi ose mungesë organizimi mund të shoqërohej me pasoja të dëmshme.** E themi këtë edhe për faktin se, koha deri në zgjedhjet e 28 qershorit është relativisht e shkurtër. Shteti duhet t'u krijojë shtetasve mundësitë reale për të ushtruar të drejtën kushtetuese për të votuar.

Mes deklaratës së Ministrisë të Brendshme të bërë publike në datë 24 mars 2009, opinionin publik informohet se duke filluar nga data e sotme, 25 mars 2009, fillon procesi i aplikimit të qytetarëve për pajisjen me pasaporta biometrike duke filluar nga Tirana. KSHH është i ndërgjegjshëm se pajisja e shtetasve shqiptarë me dokumenta të reja identiteti paraqet rëndësi të veçantë për liberalizimin e vizave, **por mendon se aktualisht ky veprim mund të vështirësojë ose të ngadalësojë procesin e pajisjes me karta identiteti të zgjedhësve që nuk kanë pasaportë.**

Është pikërisht kjo arsyeja që KSHH i sugjeron Ministrisë së Brendshme të rishqyrtojë nismën për të kaluar në të njëjtën kohë edhe në aplikimin e pajisjes së shtetasve me pasaporta biometrike.

KSHH i bën thirrje edhe njëherë **zgjedhësve që deri më sot nuk kanë aplikuar dhe nuk janë pajisur me karta identiteti, të kryejnë sa më shpejt këtë detyrë,** që garanton pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009.

Një tjetër çështje e rëndësishme dhe prioritare është njohja e zgjedhësve me listat paraprake të shpallura. Nga disa vëzhgime që kryer nga aktivistët e KSHH krijohet përshtypja se **zgjedhësit nuk janë informuar për shpalljen e listave si dhe për vendet publike ku ato janë vendosur.**

Neni 50 i Kodit Zgjedhor ngarkon kryetarët e njësive të qeverisjes vendore që nëpërmjet administratorëve në lagje dhe kryetarëve të fshatrave të bëjnë lajmërimet me shkrim për çdo zgjedhës. Në këtë njoftim, duhet të shënohet qendra e votimit, vendndodhja dhe adresa e saj, si dhe numri rendor i zgjedhësit.

KSHH i sugjeron **kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore që të shqyrtojnë këtë çështje, të ushtrorjnë kontroll për zbatimin e kësaj detyre brenda afateve të përcaktuara në ligj.**

Gjithashtu, duke mbajtur parasysh se është hartuar regjistri elektronik i gjendjes civile, KSHH i bën thirrje zgjedhësve **të verifikojnë saktësinë e emrave në listat paraprake të shpallura dhe në rast pasaktësie ose mungese, në përputhje me ligjin, të kërkojnë korrigjimin e tyre.**